

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
PROLINK shpk**

Ne Tirane, sot ne date 15.03.2023 (dymijë e njëzet e tre) ne te nënshkruarit e meposhtem ;

Z.Arlind Çela, i datelindjes 16.05.1992, lindur ne Lezhë dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike për të vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. personal J20516094R;

Z.Xholjon Pejo, i datelindjes 30.07.1995, lindur dhe banues në Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plotë juridike për të vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. personale J50730066W;

Znj.Eliza Naço, e datelindjes 14.12.1995, lindur dhe banuese ne Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi te plote juridike për të vepruar, mbajtese e leternjofimit me nr. personal J56214052P;

Z.Kevin Allaraj, i datelindjes 02.07.1996, lindur dhe banues ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike për të vepruar, mbajtes i leternjofimit me nr. personal J60702059P;

*me cilësinë e "Ortakeve Themelues", redaktojmë këtë akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarojmë se me vullnet të lire të plote e të sinqertë, dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet përkatëse, në ligjin "Për QKB", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojmë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "**PROLINK**" sh.p.k.*

**Neni 1**

**Emertimi i Shoqerise dhe forma juridike**

- 1.1 Shoqëria "PROLINK" sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizik te sipërpërmendur, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
- 1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe shoqërite tregtare", i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar Shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

**Neni 2**

**Selia**

- 2.1 Shoqëria e ka selinë në, Tirane, Rr "Abdyl Frasheri", Pallati 3/3.
- 2.2 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjese ne shoqëri te tjera, te kryeje aktivitetet ne vende te tjera, qofte brenda apo jashte territorit te Republikës se Shqiperisë, ne perputhje me vendimet e asamblese se ortakeve.



### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja**

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

### **Neni 4**

#### **Objekti**

Objekti kryesor i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj kryerjen e çdo veprimtarie të lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në veçanti: shërbime në fushën e komunikimeve elektronike si: Operator i rrjetit dhe shërbimeve për transmetim të dhënash/internet. Shërbime të transmetimit të të dhënave. Shërbime të linjave me qera. Shërbim telefonie me kartë të parapaguar. Shërbim Voip. Shërbime të transmetimit të të dhënave (data). IP TV. Shoqëria do të ushtrojë veprimtari në ndertimin e sistemeve të telekomunikacionit dhe transmetimeve audiovizive dhe ripeseritjen e tyre në çdo lloji transmetimi (satelitor tokesor, kabllor, IPTV, OTT, Internet TV) në forme të koduar apo të pakoduara, me anë të zerit, figures, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuar për publikun nëpërmjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me çdo mjet tjetër. Ushtrimin e veprimtarisë në tregtimin e aparaturave për sistemet e transmetimit dhe marrjes së valeve audiovizive dhe internetit. Ushtrimin e veprimtarisë në ndertimin dhe shfrytëzimin e rrjeteve numerike, për transmetimin satelitor, tokesor, kabllor IPTV, OTT, Internet TV me qëllim ofrimin e shërbimit të transmetimit për publikun. Prodhimin, transmetimin, ritransmetimin dhe shitjen në mënyrë dixhitale të produkteve dhe shërbimeve audio e video.

Ndertim dhe ofrim i rrjeteve të komunikacionit elektronike. Ofrim i shërbimit të internetit në Republikën e Shqipërisë. Përfshirja dhe ofrimi i përzgjedhjeve për tendera apo kompani me natyrë telekomunikacioni. Import eksport për mallra të ndryshme për nevojat e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë. Ndërmjetësime dhe pjesëmarrje në shoqëri të tjera, në përgjithësi, kryerjen e çdo veprimtarie tregtare, industriale apo transaksioni me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që lidhen me objektin e lartpërmendur të shoqërisë. Regjistrimin e domaineve .al dhe nëndomaineve ose emërtim që përfshin regjistrimin e domaineve. Shërbim publik telefonik të lëvizshëm (mobile) komunikim zanor, sms, data, shërbime me vlerë të shtuar, etj., përmes kartave me parapagim dhe paspagim në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Tregtim artikujve të ndryshëm ushqimorë, industriale, babufë, ndertime civile, etj. Restorant, hoteleri, shërbime katering, perpunim, prodhim, tregtim i lëndës së parë ushqimorë dhe shpërndarjes së saj. Në fushën e ndertimeve, punimeve të asfaltit, transport mallrash dhe udhëtarësh, tregtim karburanti, prodhim buke, tregtim brumrash, tregtim kasafortash, material elektrike, elektronike, grumbullim mbeturina skrapit, lavazho dhe pike servisi. Import-eksport dhe ndertime civile. Grumbullim, ruajtje, transport të mbetjeve urbane.



## Neni 5

### Kapitali dhe transferimi i tij

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **2,300,000 (dy milion e treqind mije) LEK ose ekuivalenti ne Euro 20,000 (njetemijë) Euro** dhe është i përbërë nga **4 kuota, vlera e te cilave zotërohet nga Ortaket si me poshtë:**

- Arlind Çela, mbajtës i 1 (nje) kuote, e cila përfaqëson 25% te kapitalit, per shumen 575,000 (peseqind e shtatedhjete e pesemije) Leke ose ekuivalenti ne Euro 5,000 (pesemijë) Euro.
- Xholjon Pejo, mbajtës i 1 (nje) kuote, e cila përfaqëson 25% te kapitalit, per shumen 575,000 (peseqind e shtatedhjete e pesemije) Leke ose ekuivalenti ne Euro, 5,000 (pesemijë) Euro.
- Eliza Naço, mbajtëse e 1 (nje) kuote, e cila përfaqëson 25% te kapitalit, per shumen 575,000 (peseqind e shtatedhjete e pesemije) Leke ose ekuivalenti ne Euro, 5,000 (pesemijë) Euro.
- Kevin Allaraj, mbajtës i 1 (nje) kuote, e cila përfaqëson 25% te kapitalit, per shumen 575,000 (peseqind e shtatedhjete e pesemije) Leke ose ekuivalenti ne Euro, 5,000 (pesemijë) Euro.

5.2 Kuotat jane te transferueshme dhe mund te transferohen ne çdo kohe ne perputhje me kushtet dhe afatet qe percaktohen ne ligjin shqiptar. Përgjegjësia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqërise.

5.3 Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

5.4 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave ne favor të tretëve jashtë shoqërisë, pa miratimin e ortakeve te shoqërise ne masen 75%. Gjithashtu ortaket e tjere te shoqërise kane te drejten e parablerjes se kuotave ne rast shitjeje duke u njoftuar nepermjet postet elektronike.**

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie

## Neni 6

### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

6.1 Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te ketij Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve te Shoqerise eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise. Ajo perfaqeson te gjithe ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithe ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve,ajo mblidhet ne selin e saj apo ne cdo vend tjeter qe ndodhet Kryetari i asamblese.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve te meposhteme:

- a) percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
- b) miratimi i ndryshimeve te statutit;
- c) emerimi e shkarkimi i anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tyre;
- d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
- e) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Keshilli Administrativ/Administratori i Vetem, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
- g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
- h) caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj anetareve te Keshillit Administrativ/Administratorit te Vetem;
- i) miratimin e riorganizimit te Shoqerise, perfshire bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen e Shoqerise, shnderrimin e Shoqerise si dhe prishjen e Shoqerise;
- j) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.
- k) ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji apo statuti.

Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet e Asamblese duke patur te drejten e votes ne raport me vleren nominale te kuotes se tij. Çdo ortak mund te perfaqesohet ne vendimarrje nga nje ortak tjeter, nga bashkeshorti(ja) ose nga çdo person tjeter, me kushtin qe perfaqesuesit te jene te pajisur me autorizimin per ate qellim.

6.2 Administratori(et) sipas gjykimit te tij te lire ose me kerkesen e nje dhe/ose me shume ortakeve te cilet perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise dhe/ose auditit ligjor nese ka, dhe/ose likuiduesit kane te drejte te therrasin Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve. Ne kete rast ortakeve duhet t'iu dergohet nje njoftim me shkrim per mbledhjen me postë

elektronike (email) jo me vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes, i cili thekson qellimin, vendin dhe oren e mbledhjes.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret te pakten nje here ne vit brenda 6 muajve nga perfundimi i vitit ushtrimor.

6.3 Pervec se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 75% (shtatedhjete e pese) te numrit total te votave .

6.4 Per te vendosur shperndarjen e fitimit, ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, anulimin, fshirjen e kuotes, largimin e ortakut si dhe riorganizimin dhe prishjen e shoqerise, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur jane te pranishem ose te perfaqesuar ortaket qe zoterojne me shume se 75% (shtatedhjete e pese) te numrit total te votave. Vendimi merret me voten pro te te pakten 75% (shtatedhjete e pese) perqind te ortakeve te pranishem.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuorunit te percaktuar me lart, ajo mblidhet perseri, por jo me vone se 30 (tridhjetete) dite, me te njejtin rend dite.

## **Neni 7**

### **Administrimi i Shoqerise**

7.1 Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga Administratori.

7.2 Administratori emerohet me vendim te Ortakeve dhe qendron ne kete detyre per nje afat jo me te gjate se 5 (pese) vjet. Administratori mund te rizgjidhet per te njejten periudhe me vendim te Ortak vete shoqerise.

7.3 Administrator i Shoqerise per nje periudhe 5 vjecare do te jete:

Z.Xholjon Pejo, i datelindjes 30.07.1995, lindur dhe banues në Tirane, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plotë juridike për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. personale J50730066W


Administratori mund te shkarkohet me vendim te ortakeve ne çdo moment per arsye te justifikuara.

7.4 Administratori eshte personalisht pergjegjes perpara Shoqerise dhe/ose paleve te treta per deme te shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ketij Statuti ose te Ligjit.

## **Neni 8**

### **Detyrat dhe Kompetencat e Administratorit**

8.1 Pasuria dhe aktiviteti tregtar i Shoqerise do te administrohen nga Administratori, i cili ka te drejte te ushtroje te gjitha kompetencat qe gjykon te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, me perjashtim te atyre qe ky statut dhe ligji i ka rezervuar Ortakeve te Shoqerise. Administratori mund te autorizoj apo emeroje me ane te prokures persona te trete per kryerjen e veprimtarive dhe/ose kompetencave qe i perkasin Administratoreve.



- 8.2 Kompetencat e Administratorit ne lidhje me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise percaktohen por pa u kufizuar, si me poshte vijon.
- (a) Te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
  - (b) Te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standardet kontabel;
  - (c) Te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise;
  - (d) Te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta, entiteve publike apo private, si dhe entiteve/ose autoriteteve vendase ose te huaja;
  - (e) Te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise te cilat do te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
  - (f) Te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te ne fuqi;
  - (g) T'i raportoje Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te veçante per Shoqerine;
  - (h) Te punesoje dhe te shkarkoje punonjes sipas politikave te shoqerise;
  - (i) Te hartoje dhe te nenshkruaje deklaratat tatimore dhe cdo akt tjetër qe ka lidhje me dokumentacionin qe duhet te dorezohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ose autoriteteve te tjera.
  - (j) te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

### **Neni 9 Auditi Ligjor**


- 9.1 Auditi Ligjor do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rastet kur kjo eshte kerkese e legjislacionit shqiptar. Riemerimi do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Auditi Ligjor mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast te shkeljeve te detyrave, gabimeve dhe sjelljes jo te mire profesionale.

### **Neni 10 Viti Ushtrimor**

- 10.1 Viti Ushtrimor fillon ne 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon me date 31 Dhjetor 2023.

### **Neni 11 Shperndarja dhe Prishja**

- 11.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Shperndarja e shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.



- 11.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, i cili do te sherbeje per qellimet e likuidimit dhe emrin e shoqerise do ta pasojne fjalet “ne proçes likuidimi”
- 11.3 Likudatori(et) do te emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i likuidatorit(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 12**

#### **Ligji i Zbatueshem**

- 12.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.
- 12.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar per shoqerite tregtare.

### **Neni 13**

#### **Mosmarreveshjet**

- 13.1 Per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e ketij statuti dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde ndermjet Shoqerise dhe paleve te treta, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jene gjykatat shqiptare.

### **Neni 14**

#### **Ndryshimet**

- 14.1 Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- 14.2 Ky statut i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar PROLINK Shpk hartohet ne 3 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejte secila.

### **ORTAKET E SHOQERISE PROLINK SHPK**



Eliza Nogo  
Eliza

Kevin Allaraj  


Adil Kech  
